



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr 01-112601-1554/
Datë 04.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 67, 68 dhe 69 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Përzgjedhjes për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën *Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare* sipas konkursit me numër 01-111/01-15452 të datës 04.08.2023.
2. Komisionin e Përzgjedhjes nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Dervish Tahiri – Kryesues (Drejtor i Qendrës për Punë Sociale)
 - 2.2. Teuta Krasniqi – Anëtare (Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore)
 - 2.3. Dafina Kazazi Olloni – Anëtare (Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë)
 - 2.4. Hamdi Kameri – Anëtarë (Specialist i Mjekësisë Familjare)
 - 2.5. Engjëll Berisha – Anëtarë (Drejtor i Bibliotekës “Ibrahim Rugova”)
3. Komisioni i Përzgjedhjes, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen procedurave të vlerësimit nëpërmjet testimit me shkrim dhe të intervistës me gojë, për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. Komisioni pas përfundimit të procedurës së rekrutimit shpërbëhet menjëherë.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 67, 68 dhe 69 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar në pozitën *Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare*, në konkursin me numër 01-111/01-15452 të datës 04.08.2023, u caktua komisioni që të bëjë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Komisionit të Përzgjedhjes
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës